

VENDIM
Nr.886, datë 22.8.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE DHE
AUTOMJETEVE USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të disa autokolonave ushtarake slovene, në:

a) datën 22 gusht 2009, një autokolonë e përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 10 (dhjetë) persona, në itinerarin Morinë-Durrës;

b) datën 23 gusht 2009, 1 (një) autokolonë e përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) persona, në itinerarin Morinë-Durrës;

c) datën 24 gusht 2009, 3 (tri) autokolona të përbëra, si më poshtë vijon:

i) autokolona e parë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) persona;

ii) autokolona e dytë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 37 (tridhjetë e shtatë) persona;

iii) 1 (një) automjet dhe 2 (dy) persona);

Itinerari i lëvizjes së këtyre autokolonave është Durrës-Morinë.

ç) datën 26 gusht 2009, 2 (dy) autokolona, të përbëra si më poshtë vijon:

i) nga 1 (një) automjet dhe 2 (dy) persona, në itinerarin Qafë-Thanë-Durrës;

ii) autokolona e dytë nga 22 (njëzet e dy) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) persona, në itinerarin Morinë-Durrës;

d) datën 27 gusht 2009, 1 (një) autokolonë, e përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 9 (nëntë) persona, në itinerarin Durrës-Morinë;

dh) datë 28 gusht 2009, vetëm 1 (një) automjet dhe 2 (dy) persona, në itinerarin Durrës-Morinë.

2. Autokolonat dhe automjetet ushtarake slovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha